

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 9 MAJ 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

E kërkova fjalën për t'i dhënë përgjigje kolegut deputet, zotit Gështenja, në lidhje me pyetjet që ngriti.

Së pari, për sa u takon mësuesve të Librazhdit dhe të Përrenjasit, zoti Gështenja, ju deklaruat këtu që mësuesit nuk janë paguar për orët suplementare, për transportin, madje nuk është bërë edhe pagesa e sigurimeve shoqërore. Nuk e mora fjalën menjëherë pas jush, sepse doja të bëja verifikimet e fundit për informacionin që kisha dhe më rezultoi se në Librazhd, sot që flasim, nuk ka asnjë pagesë dhe asnjë detyrim të prapambetur për mësuesit e kësaj bashkie qoftë për orët suplementare, qoftë për pagesën e transportit apo për sigurimet shoqërore. Ndërkohë, për mësuesit e Përrenjasit nuk janë paguar orët suplementare vetëm 3 muajt e fundit, por tashmë kjo çështje është zgjidhur, të gjitha listëprezencat janë dorëzuar në institucionet përkatëse dhe sot ose nesër pagesa do të ketë kaluar. Pra, janë të gjitha të zgjidhura. Nesër ju mund të shkoni në Përrenjas dhe me mësuesit e zonës mund ta verifikoni që u kanë shkuar të gjitha paratë, ndërsa pagat, paratë e transportit dhe sigurimet shoqërore janë të gjitha të zgjidhura. Për sa i takon pyetjes së dytë se kur do t'i rrisim pagat e mësuesve, në mandatin e kaluar pagat e mësuesve u rritën me 32%, pavarësisht vështirësive të mëdha që kaluam, si tërmeti apo pandemia.

Ndërkohë, këtë mandat jemi angazhuar që pagat e mësuesve do të rriten me 40% dhe e kemi nisur këtë hap që këtë vit. Nga korriku të gjithë mësuesit do të pagohen 6% më shumë. Do të kishim dashur shumë më tepër, natyrisht mësuesit meritojnë shumë më tepër, por ky është vetëm hapi i parë dhe ne do të bëjmë maksimumin që t'i përmbahemi premtimit për 40% rritje pagash deri në fund të mandatit. Për sa i takon pyetjes së tretë, ku deklaruat se mësuesit emërohen sipas bindjeve partiake, ju e dini shumë mirë, zoti Gështenja, se kjo nuk është e vërtetë. Kjo mund të ketë ndodhur para shumë vitesh, madje jo vetëm sipas bindjeve partiake, por edhe sipas shumë mënyrave të tjera të jashtëligjshme, ndërsa sot të gjithë mësuesit emërohen sipas portalit "Mësues për Shqipërinë".

Nëse ju keni ndonjë rast ku një mësues është emëruar pa qenë pjesë e portalit, mund ta denonconi, ju lutem, madje ma sillni edhe mua këtë informacion, por ju nuk mund të hidhni akuza se sot mësuesit punësohen sipas bindjeve partiake, sepse nuk është e vërtetë. Hajdeni me fakte! Nëse keni fakte dhe emra, i mirëpres që së bashku t'i marrim masat dhe personat përgjegjës të përgjigjen. Faleminderit!